



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH

Numri i lëndës: 2021:102994

Datë: 24.09.2024

Numri i dokumentit: 06204006

C.nr. 28/21

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, me gjyqtar Sabaheta Kurteshi dhe procesmbajtës Senida Nuri, në çështjen juridiko-kontestimore të paditësve V. T. me numër personal..., me vendbanim në B., A. T. me numër personal..., me vendbanim në B., N. K. me numër personal..., me vendbanim në K., D. T. me numër personal..., me vendbanim në B., K. T. me numër personal..., me vendbanim në B., G. T. me numër personal..., me vendbanim në B., Komuna e Dragashit te cilet me autorizim i perfaqeson av Xh. B. nga Prishtina, Lagja K. Rr. "I. A. " H., banesa nr ..., kundër të paditues Byroja Kosovare e Sigurimeve,,BKS" Prishtinë, lidhur me padin per kompensim demi pas mbajtjes se shqyrtimit kryesor me datë 29.08.2024, me datë 24.09.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR kërkesë padia e paditësve V. T. me numër personal..., me vendbanim në B., A. T. me numër personal..., me vendbanim në B., N. K. me numër personal..., me vendbanim në K., D. T. me numër personal..., me vendbanim në B., K. T. me numër personal..., me vendbanim në B., G. T. me numër personal..., me vendbanim në B., Komuna e Dragashit .

II. DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve Byroja Kosovare e Sigurimeve,,BKS" Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit, për aksidentin e dt. 01.05.2021, që ta kompensojë paditësi dhe atë: I. Paditësen V. T. nga fshati..., Komuna Dragash dhe atë:

Për DÉMIN JO MATERIAL.

Për te gjitha dhimbjet fizike shumën prej 1.500.00€

Për te gjitha format e Frikës shumën prej 1.100.00€

DËMIN MATERIAL

Për Ndhimën e Huaj për 14 ditë X 10.00€ ne shumë prej 140.00€

Për Ushqim te përforcuar për 20 dit X 7.00€ ne shumë prej 140.00€

2.Paditësen D. T. nga fshati..., komuna Dragash dhe atë për:

DËMIN JOMATERIAL

Për te gjitha dhimbjet fizike shumën prej 1.500.00€

Për te gjitha format e Fikës shumën prej 1.100,00€

DËMIN MATERIAL

Për Ndhmën e Huai për 14 ditë X10 €ne shumë prej 140.00€
Për Ushqim te përforcuar për 20 ditë X 7,00 ne shumë prej 140.00€

3.Paditësen A. T. nga fshati..., komuna Dragash dhe atë për :

DËMIN JOMATERIAL

Për te gjitha dhimbjet fizike shumë prej 1,500.00€
Për te gjitha format e Fikës shumë prej 1,100.00€

DÉMIN MATERIAL

Për Ndhmën e Huaj për 14 ditë X 10 € ne shumë prej 140.00€
Për Ushqim te përforcuar për 20 ditëX 7.00€ ne shumë prej 140.00€

4.Paditësen K. T. nga fshati..., komuna Dragash dhe atë për:

DËMIN JOMATERIAL.

Për te gjitha dhimbjet fizike shumë prej 1.500.00€
Për te gjitha format e Fikës shumë prej 1.100.00€

DÉMIN MATERIAL

Për Ndhmën e Huaj për 14 ditë X 10.00€ ne shumë prej 140,00€
Për Ushqim te përforcuar për 20ditX 7.00€ ne shumë prej 140.00€

5.Paditësen N. K. nga fshati..., komuna Dragash dhe atë për:

DËMIN JOMATERIAL.

Për te gjitha dhimbjet fizike shumë prej 1,500.00 €
Për te gjitha format e Fikës shumë prej 1.100.00 €

DÉMIN MATERIAL

Për Ndhmën e Huaj për 14 ditë X 10.00€ ne shumë prej 140.00€
Për Ushqim te përforcuar për 20 ditX 7.00€ ne shumë prej 140.00€,

Gjithsejtë në shumë prej 14,400.00(katërmbëdhjetëmijë e katër qindtë euro) €

III.DETYROHET Kompania e Sigurimeve BKS me seli në Prishtinë, qe shuma e përgjithshme prej 13,000.00 (trembëdhjetëmijë)€ për Demin Jomaterial te llogariten më kamatë prej 8⁰/0 nga dita e nxjerrjes së Aktgjykimit te shkalle se parë ndërsa shumat e kompensimit për demin material prej 1,400.00(njëmijë e katër qindtë)€ që lidhen me demin jo material te llogariten me kamatë prej 8⁰/0 nga data e aksidentit 01.05.2021 e deri në pagesën definitive, (sipas mendimit juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës Nr. 265/2020 të datës 02.12.2020) e të gjitha këto në afat prej 15 dite, nga dita e plotefuqishmeris së këtij aktgjykimi, nën kërcenimin e përmbarimit me detyrueshëm.

IV.DETYROHET Kompania e Sigurimeve BKS me seli në Prishtinë, që në emër të shpenzimeve të e procedurës ti paguaj gjithsejtë shumë prej 5,517.00 (pesëmijë e pesëqindtë e

shtatëmbëdhjetë euro) € në bazë të TA-së së aplikueshme nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përbarimit me detyrueshëm.

V. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadiisë mbi shumat e aprovuare në shumë prej 14,400.00 euro dhe të në shumë prej 11,150.00€ (nimbëdhjetë mijë e njëqindtë pesëdhjetë euro) dhe atë për frikë shumen prej 5,000.00(pesëmijë)€, ne emër te dhembjeve fizike shumen prej 5,000.00 (pesëmijë)€, dhe ne emër te shpenzimeve të ushqimit dhe për ndihmë personit të tretë -materiale shumen prej 1,150.00(njëmijë e një qindtë e pesëdhjetë) € SI E PA BAZUAR

VI.REFUZOHET pjesa tjetër e shpenzimeve të procedurës mbi shumat e aprovuare në shumë prej 5,517.00(pesëmijë pesëqindtë e shtatëmbëdhjetë) € euro dhe atë në shumë prej 3,260.00(tremijë dyqindtë e gjashtëdhjetë) € SI E PA BAZUAR.

Ar sy e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Pala paditëse përmes të autorizuarit të saj me datë 26 Maj 2021, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi me objekt kontesti kompensim demi të rastit të siguar, tek e paditura, ku si provë ia ka bashkangjitur provat si ne padi duke i popozuar gjzkates qe njehta te aprovohet si e bazuar . I autorizuari i palës paditëse Av. Xh. B. gjat seancave ka deklaruar: - mbetem pranë padisë dhe kërkesëpadiisë, pasi e paditura në përgjigje në padi e ka kontestuar bazën dhe lartësinë e kërkesëpadiisë, gjykatës i propozoj që të nxirret prova me ekspertizë të komunikacionit, me të cilën do të vërtetohen faktet si në vijim: - nuk është kontestuese se aksidenti ka ndodhur në udhë kryqin e fshatit P.-Dragash, ku pjesëmarrës kanë qenë dy automjete. Automjeti A i përshkruar në raportin policor dhe automjeti B. Të sqarohet shkaktari i aksidentit kur dihet se lëshime në shkaktimin e aksidentit ka pasur automjeti A, ndërsa mendoj që kontribut në shkaktimin e aksidentit përkatësisht lëshime sekondare ka pasur edhe automjeti B, duke e vozitur me shpejtësi të lartë. Duke u mbështetur në procedurën e provave e në veçanti ne mendimin e dhënë nga ekspertet mjekësore të dhënë nga Dr. Rr. Sh.-Ortoped-trumatolog dhe Dr.N. F. -Psikiatër, dhe Superekspertizë te Komunikacionit dhe Ekspertizë për demin material ne automjet, nga gjykata më është bërë munduar që të bëj precizimin e kërkesëpadiisë duke e ri konfirmuar padinë me ndryshime sa I përket lartësisë së kompensimit të gjitha formave të dëmit duke u mbështetur në dispozitat ligjore dhe mendimin e mjekëve si në vijim: Paditësia V. T., nga aksidenti 1 komunikacionit të datë 01.05.2021 ka pësuar Lendime te lehta trupore ku ka përjetuar dhimbje: Dhimbje fizike të Intensitetit posaçërisht të RËNDË 30 minuta, Dhimbje fizike të Intensitetit të rende I ditë Dhimbje fizike të Intensiteti të MESEM 14 ditë, Dhimbje fizike te Intensitetit të ult ka edhe tani Kërkesa për kompensim për të gjitha format e dhimbjeve është në shumët prej 2,500.00 euro .Paditësi nga aksidenti i komunikacioni ka përjetuar të gjitha format e frikës dha ato si në vijim:Frika primare(në formë të frikës nga vdekja)që ka zgjatur 2-3 sekonda, Frika Sekondare intensitet te lartë që ka zgjatur I ditë, Fika Sekondare e intensiteti të MESEM ulët ka zgjatur 7 ditë, Fika Sekondare e intensiteti të ult ka zgjatur 10 muaj.Kërkesa për kompensim për të gjitha format e FRIKËS është në shumë prej ~~2.100.~~. Ndhimja e huaj ka qenë e nevojshme prej 14 ditëve, kërkoje shumen prej 210.00€. Ushqim I përforcuar ka qenë I nevojshëm për 20 ditëve kërkojë shumen prej ~~300.00€.~~ Paditësia D. T.,nga aksidenti 1 komunikacionit të datë 01.05.2021 ka pësuar LËNDIME TË LEHTA TRUPORE ku ka përjetuar:dhimbje si: dhimbje fizike të Intensitetit posaçërisht të rend 30 minuta, Dhimbje fizike të Intensitetit të rende 1 ditë Dhimbje fizike të Intensiteti të mesem14 ditë, Dhimbje fizike te Intensitetit të ulte ka edhe tani Kërkesa për kompensim për të Rjitha format e dhimbjeve është në shumët ~~---2.500.~~ Paditësja nga aksidenti i komunikacioni ka përjetuar të gjitha format e frikës dha ato si në vijim:Frika primare(në formë

të frikës nga vdekja)që ka zgjatur 2-3 sekonda, Frika Sekondare intensitet te lartë që ka zgjatur I ditë, Fika Sekondare e intensiteti të mesem i ulët ka zgjatur 7 ditë, Fika Sekondare e intensiteti të ult ka zgjatur 10 muaj.Kërkesa për kompensim për të gjitha format e FRIKËS është në shumë 2.100.00€.Ndihma e huaj ka qenë e nevojshme prej 14 ditëve, kërkoje shumen prej **210.00**. Ushqim I përforcuar ka qenë I nevojshëm për 20 ditëve kërkojë shumen prej 300.00€. Padiësia A. T.,nga aksidenti 1 komunikacionit të datë 01.05.2021 ka pësuar LËNDIME TË LEHTA TRUPORE ku ka përjetuar dhimbje: Dhimbje fizike të Intensitetit posaçërisht të rende 30 minuta, Dhimbje fizike të Intensitetit të rende I ditë Dhimbje fizike të Intensiteti të mesem 14 ditë, Dhimbje fizike te Intensitetit të ult ka edhe tani Kërkesa për kompensim për të gjitha format e dhimbjeve është në shumë ---2.500.00€ Padiësja nga aksidenti i komunikacioni ka përjetuar të gjitha format e frikës dha ato si në vijim: Frika primare(në formë të frikës nga vdekja)që ka zgjatur 2-3 sekonda, Frika Sekondare intensitet te lartë që ka zgjatur I ditë, Fika Sekondare e intensiteti të mesem ulët ka zgjatur 7 ditë, Fika Sekondare e intensiteti të ULT ka zgjatur 10 muaj.Kërkesa për kompensim për të gjitha format e FRIKËS është në shumë 2,100.00 euro.Ndihma e huaj ka qenë e nevojshme prej 14 ditëve, kërkoje shumen prej **210.0** Ushqim I përforcuar ka qenë I nevojshëm për 20 ditëve kërkojë shumen prej **300.00**. Padiësia Kosovare TAHIRI,nga aksidenti 1 komunikacionit të datë 01.05.2021 ka pësuar LËNDIME TË LEHTA TRUPORE ku ka përjetuar:DHIMBJE:dhimbje fizike të Intensitetit posaçërisht të RËNDË 30 minuta, Dhimbje fizike të Intensitetit të RËNDË I ditë Dhimbje fizike të Intensiteti të MESEM 14 ditë, Dhimbje fizike te Intensitetit të ULTË ka edhe tani Kërkesa për kompensim për të gjitha format e dhimbjeve është në shumë ---2.500.00€ Padiësja nga aksidenti i komunikacioni ka përjetuar të gjitha format e frikës dha ato si në vijim:Frika primare(në formë të frikës nga vdekja)që ka zgjatur 2-3 sekonda, Frika Sekondare intensitet te lartë që ka zgjatur 1 ditë, Fika Sekondare e intensiteti të MESEM ulët ka zgjatur 7 ditë, Fika Sekondare e intensiteti të ULT ka zgjatur 10 muaj. Kërkesa për kompensim për të gjitha format e FRIKËS është në shumë **2.100** euro.Ndihma e huaj ka qenë e nevojshme prej 14 ditëve, kërkoje shumen prej **210.00**. Ushqim I përforcuar ka qenë I nevojshëm për 20 ditëve kërkojë shumen prej **300.00**. Padiësia N. T. Nga aksidenti 1 komunikacionit të datë 01.05.2021 ka pësuar LËNDIME TË LEHTA TRUPORE ku ka përjetuar dhimbje :Dhimbje fizike të Intensitetit posaçërisht të rende 30 minuta, Dhimbje fizike të Intensitetit të rende ditë Dhimbje fizike të Intensiteti të mesem 14 ditë, Dhimbje fizike te Intensitetit të ulte ka edhe tani.Kërkesa për kompensim për të gjitha format e dhimbjeve është në shumë prej 2,000.00 euro. Padiësja nga aksidenti i komunikacioni ka përjetuar të gjitha format e frikës dha ato si në vijim:Frika primare(në formë të frikës nga vdekja)që ka zgjatur 2-3 sekonda, Frika Sekondare intensitet te lartë që ka zgjatur I ditë, Fika Sekondare e intensiteti të mesem ulët ka zgjatur 7 ditë, Fika Sekondare e intensiteti të ulte ka zgjatur 10 muaj.Kërkesa për kompensim për të gjitha format e FRIKËS është në shumë prej 2,000.00 euro.Ndihma e huaj ka qenë e nevojshme prej 14 ditëve, kërkoje shumen prej 210.00€. Ushqim I përforcuar ka qenë I nevojshëm për 20 ditëve kërkojë shumen prej 300.00€.Ndërsa ne *fjalën perfundimtare ka deklaruar* : nuk është kontestuese se padiësit V. T., D. T., A. T., K. T. dhe N. K. si pasojë të aksidentit të dt. 01.05.2021 kanë pësuar lëndimet trupore, kjo është vërtetuar edhe me ekspertizën e ekspertit ortoped, traumatolog dhe me ekspertizën e mjekut psikiatër. Lidhur me bazën e shkaktimit të aksidentit është vërtetuar edhe me ekspertizën e komunikacionit nga grupi i ekspertëve. Pas nxjerrjes e këtyre provave kam bërë precizimin e kërkesëpadiësë për të gjithë padiësit ku kërkoj nga gjykata që të aprovohet precizimi i kërkesëpadiësë për të gjithë padiësit dhe të detyrohet e paditura qe ti kompensoj padiësit si në precizim si dhe kërkojmë kumatën për dëmin material nga dita e shkaktimit të dëmit ndërsa për dëmin jo material nga dita e nxjerrjes së Aktgjykimit. Precizimin e kërkesëpadiësë për dëmin e kam mbështetur në udhëzuesin 41/23 të dt. 27.02.2023 të Gjykatës Supreme të Kosovës. Të detyrohet e paditura BKS ti kompensoj dhe shpenzimet e procedurës kontesitmore të cekura si në precizim dhe në vend ku është shënuar K.S. “E.” të jetë BKS. Shumat e kompensimit janë të bazuar në UDHEZUESIN nr.41/23dt.27.02.2023 te Gjykatës Supreme të Kosovës.

Përfaqësuesi i të paditurës av Sh. R. në fjalën e vet përfundimtare ka deklaruar: - mbes në tërësi pranë deklaratave nga seancat e kaluar, e paditura e konteston padinë dhe precizimin e saj vetëm për lartësinë pasi që baza juridike e padisë është vërtetuar në super ekspertizën nga lëmia komunikacionit. E paditura e konteston lartësinë për faktin se shuma e precizuara si në parashtrësën e dorëzuar sot në këtë seancë janë shumë të larta dhe në disproporcion me ekspertizën mjekësore të punuara në këtë procedurë e që në rastin konkret këto shuma të kërkuara nuk paraqesin satisfakcion por kanë qëllime tjera materiale që mund të bien ndesh me qëllimin e satisfakcionit në këtë rast. Andaj i propozojmë gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e palëve paditëse ta refuzoj si të pa bazuar mbi shuma e ofruara nga e paditura në këtë seancë. Sa i për këtë shpenzimeve të procedurës i propozojmë gjykatës që të njëjtat të gjykohen në bazë të suksesit në procedurë ashtu që të refuzohet çdo shpenzim i shkaktuar pa fajin e të paditurës si dhe gjykata të ketë parasysh faktin se në këtë procedurë janë mbajtur 7 seanca me këtë të sotme dhe jo 8 siç i ka kërkuar i autorizuari i paditësve si dhe në seancën e parë i njëjti i ka përfaqësuar vetëm 2 paditëse ndërsa në seancën e dytë i ka përfaqësues 4 paditëse për dallim nga seancat të tjera ku janë përfaqësuar 6 paditës. Lidhur me kamatën e kërkuar e kontestojmë në tërësi pasi që e paditura ka qen e gatshme që këtë çështje në tërësi ta mbylli me marrëveshje mirëpo palët paditëse nuk kanë shprehur gatishmërinë. Mirëpo në rast të aprovimin nga ana e gjykatës atëherë kamata e kërkuar për dëmin material nuk mund të llogaritet nga dita e shkaktimit të dëmit pasi që kjo bie ndesh me mendimin juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Gjykata me aktvendim te datës 07.09.2021 konform nenit 408.1 është bërë bashkimi i lëndëve C.nr. 28/21 dhe 29/21 ashtu që lendet e bashkuar janë evidentuar dhe janë udhëhequr me nr. C.nr. 28/21 .

Gjendja faktike e vërtetuar

Gjykata më qëllim të konstatimit dhe vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike ka administruar provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe atë: lexohet përmbajtja e raportit të aksidentit .. Bëhet leximi në raportin e aksidentit të përpiluar nga Policia e Kosovës, të dt. 01.05.2021, me nr. Të rastit 2021-GR-273, lexohet në raportin mjekësor për K. T., të lëshuar nga Qendra emergjente e Spitalit Regjional Prim.Dr. Daut Mustafa në Prizren, me numër të protokollit 7758 të dt. 01.05.2021, leximi i udhëzimit të dt. 01.05.2021, për K. T., leximi i certifikatës së regjistrimit të automjeteve me nr. 04-639-FH, leximi në kopjen e patent shoferit për paditësen K. T., leximi në kërkesën e paditëses K. T. drejtuar të paditurës për dëmshpërblim të dt. 20.05.2021, shikimi në foto dokumentacionin nga vendi i ngjarjes, leximi në raportin mjekësor të lëshuar nga Qendra emergjente e Spitalit Rajonal Prim.Dr. Daut Mustafa në Prizren, me numër të protokollit 7740 të dt. 01.05.2021, për paditësen V. T., leximi në raportin mjekësor të lëshuar nga Qendra emergjente e Spitalit Rajonal Prim.Dr. Daut Mustafa në Prizren, me numër të protokollit 7741 të dt. 01.05.2021, për paditësen D. T., leximi në raportin mjekësor të lëshuar nga Qendra emergjente e Spitalit Rajonal Prim.Dr. Daut Mustafa në Prizren, me numër të protokollit 7739 të dt. 01.05.2021, për paditësen A. T., leximi në Udhëzimin për paditësen Anita Tahiri, të dt. 01.05.2021, leximi i certifikatës së lindjes për paditësen A. T., leximi i patent shoferit për paditësin G. T., leximi në raportin mjekësor të lëshuar nga Qendra emergjente e Spitalit Rajonal Prim.Dr. Daut Mustafa në Prizren, me numër të protokollit 7742 të dt. 01.05.2021, për paditësen N. K., leximi ne raportin policor me nr. 2021-GR-273, nga aksidenti i dt. 01.05.2021; udhëzimi mjekësor me nr. 063946 i dt. 01.05.2021; raporti mjekësor nga Siptali regjional i Prizrenit me nr. 7758 i dt. 01.05.2021; kopjen e letërnjoftimit të të dëmtuarës K. T.; Çertifikata e regjistrimit të automjetit CR.....; Kopjen e letërnjoftimit të të dëmtuarit G. T.; Foto nga vendi i ngjarjes Lexohet përmbajtja e ekspertizës nga Prof..Asoc. Dr. N. F. e dt. 16.07.2024.

Gjykata pas vlerësimit të provave materiale, deklarimeve të palëve ndërgjyqës dhe administrimit të provave të lartcekura në kuptim të nenit 8 të Ligjit Për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar dhe vlerësuar çdo provë veç e veç dhe të gjithat së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Nga leximi i përmbajtjes së raportin e aksidentit të përpiluar nga Policia e Kosovës, të dt. 01.05.2021, me nr. të rastit 2021-GR-273, si dhe shikimi në skicë nga vendi i ngjarjes i të njëjtës datë, nga përmbajtja e raportit i oficerit mbi aksidentit nr. i rastit, 2021-GR-273 gjykata ka vërtetuar faktin se me dt. 01.05.2021 rreth orës 14,45 ka ndodhur një aksident neudhekryqin qe lidhet rruga Dragash –Prizren ne rrugen e fshatrave te Opojes – ne fshatin P. K.e Dragashit , ku aksidenti ka ardhur ku drejtuesi i vetures Audi A-3 me targa te regjistrimit 04-6...-F... me gjyre te verdh e cila ishte duke levizur me mjetin e saj nga drejtimi i rruges se fshatrave te Opojes, saktesisht nga drejtimi i fshatit Z. ne drejtim te Dragashit, me te arritur te udhekryqi i fshatit Pllave i cili e lidh rrugen nacionle Dragash – Prizren , ne ate moment duke mos u siguruar mir per veprimet e pa kontrolluara me mjetin e saj , si dhe duke u futur ne menyrt te pa kujdesshme ne udhekryq ne drejtim te Dragashit , keshtu qe ne ate moment vettura VW Golf me targa BA-...-05... me ngjyr te hirit e cila ishte duke levizur nga drejtimi i Dragashit ne drejtim te Prizrenit ne te arritur ne ate vend duke mos mundur te ndaloj automjetin pasi qe pengesa ishte ne menyrt te befasishme , me pjesen e par ballore te mjetit te tij e godet veturen AUDI A-3 ne mes te dyerve te anes se majt , dhe ne kete aksident trafiku shkaktohen deme materiale ne dy veturat si dhe lendime pesojn; paditesit dhe ate lendime te lehta trupore .

Gjithashtu gjykata ka vërtetuar se automjetit, VW Golf me targa BA-...-05.. me ngjyr te hirit te cilin e drejtonte M. G., ka qen e siguruar- ka pasur sigurimin - mbules siguruese kufitare –polic kufitare Kompania e sigurimeve –Byroja e kjo është vërtetuar ne bazë te polices se sigurimit Nr.0355.... e vlefshme deri me date 14.05.2021.

Nga leximi I përmbajtjes dhe atë: për K. T., të lëshuar nga Qendra emergjente e Spitalit Regjional Prim.Dr. Daut Mustafa në Prizren, me numër të protokollit 7758 të dt. 01.05.2021, leximi i udhëzimit të dt. 01.05.2021, për K. T., leximi i certifikatës së regjistrimit të automjeteve me nr. 04-6...-F..., leximi në kopjen e patent shoferit për paditësen K. T., leximi në kërkesën e paditëses K. T. drejtuar të paditurës për dëmshpërbllim të dt. 20.05.2021, shikimi në foto dokumentacionin nga vendi i ngjarjes, leximi në raportin mjekësor të lëshuar nga Qendra emergjente e Spitalit Rajonal Prim.Dr. Daut Mustafa në Prizren, me numër të protokollit 7740 të dt. 01.05.2021, për paditësen V. T., leximi në raportin mjekësor të lëshuar nga Qendra emergjente e Spitalit Rajonal Prim.Dr. Daut Mustafa në Prizren, me numër të protokollit 7741 të dt. 01.05.2021, për paditësen Denusha Tahiri, leximi në raportin mjekësor të lëshuar nga Qendra emergjente e Spitalit Rajonal Prim.Dr. Daut Mustafa në Prizren, me numër të protokollit 7739 të dt. 01.05.2021, për paditësen A. T., leximi në Udhëzimin për paditësen A. T., të dt. 01.05.2021, leximi i certifikatës së lindjes për paditësen A. T., leximi në raportin mjekësor të lëshuar nga Qendra emergjente e Spitalit Rajonal Prim.Dr. Daut Mustafa në Prizren, me numër të protokollit 7742 të dt. 01.05.2021, për paditësen N. K., udhëzimi mjekësor me nr. 063946 i dt. 01.05.2021; raporti mjekësor nga Siptali regjional i Prizrenit me nr. 7758 i dt. 01.05.2021; gjykata ka vërtetuar se si rezultat i aksidentit - fatkeqësie ne komunikacion paditësit kan pësuar lëndime te lehta trupore te cilat janë përball me dhimbje fizike, frike, pastaj ka qene e nevojshme ushqimi I përforcuar , ndihma e personit te trete , si dhe për shërim –gjate shërimit janë bere dhe shpenzime tjera , si dhe ne baze te këtyre raporteve mjekësore, flete lëshimeve jan konstatuar dhe diagnoza per paditësiit (me gjerësisht shihe raportet dhe fletë lëshimet si dhe konsultat).

Nga përmbajtja leximi i patent shoferit për paditësin G. T. gjykta ka verteuar se ka pas patent shofer te aftshem .

Për të vërtetuar lartësinë e kërkesë padisë, gjykata sipas propozimit të palëve, në cilësinë e provave materiale ka nxjerrë ekspertizën mjekësore nga eksperti ortoped –traumatolog Rr. Sh. dhe ekspertizën nga eksperti Prof Dr. N. F., të cilët kanë dhënë mendimin e tyre profesional pas ekzaminimit të drejtpërdrejt të paditësin, të cilin mendim e kanë dhenë me shkrim dhe të cilët janë deklaruar për natyrën, shkallën dhe pasojat e lëndimeve që ka pësuar paditësi si pasoi e këtij aksidenti

Me ekspertizën ekspertit të ortopedisë DR. Rr. Sh. të paraqitur me shkrim me dt. 06.07.2024 gjykata ka vërtetuar se ky ekspert Pas shqyrtimit të dokumentacionit mjekësor nga shkresat e lëndës ka dhen këte mendim dhe atë: per paditesen V. T. Ne baze te egzaminimit te dokumentacionit mjekesor ne shkresat e lendes,dokumentacionit shtese te cilat i kame kerkuar per egzarninim si dhe egzaminimit te drejtperdrejt te paditesit konstatoj se ne aksidentin e pesuar me daten 01.05.2021 ka marre keto lendime: Ka pesuar keto lendime ndrydhje e kokes qafes,dhe brrylit te djathte . Te gjithë keto lendime klasifikohen si lendime te lehta trupore,te cilat kane shkaktuar dhimbje fizike:a)dhimbje fizike te intenziteti te posaqerisht te larte 30 min duke llogaritur Kohen prqj aksidentit deri na marrjen e terapis.b)dhimbje fizike te intenzitetit le rende 24 ore(kohe pas kohe deri ne marrjen e terapis adekuate),c) dhimbje fizike te intenzitetit te mesem 14 dite(kohe pas kohe deri ne marrjen eterapis adekuate duke llogaritur fillimin e konsolidimit te organizmit si pasoj e lendimit ne aksident. d)dhimbje fizike te intenzitetit te ulet sipas te dhenave te marra direkt nga paditesi ka edhe sote e kesaj dite sidomas pas sforcimeve Erike dhe ndryshimeve klimatike. 2.Zvoglim te aktivitetit jetesor nuk ka,3 .Shemtim trupor nuk Ica. 4.Ndihma e personit tjetër ka qene e nevojshme per 4 ditesh per shkake te traumes. 5.Ushqim i perforcuar ka qene i dornosdoshem ne kohezgjatje prej 20 diteve ne kuptim te perzgjedhjes se ushqimit te pasur me materiet e nevojshme per rikuperimin e organizmit pas traumes.6.Rehabilitimi fizioterapeutik dhe klimatik ka qene i nevojshem ne kohezgjatje prej 10 ditesh per vitin e pare pas aksidentit . **Per** paditesen D. T. Ne baze te egzaminimit te dokumentacionit mjekesor ne shkresat e lendes,dokumentacionit shtese te ci)at i kame kerkuar per egzaminim si dhe egzaminimit te drejtperdrejt te paditeses konstatoj se ne aksidentin e pesuar me daten 01.05.2021 ka marre keto lendirne: Ka pesuar keto lendime ndrydhje e kokes qafes, dhe gjoksit.Te gjithë keto lendoime klasifikohen si lendime te lehta trupore,te cilat kane shkaktuar dhimbje fizike. a)dhimbje fizike te intenziteti te posaqerisht te larte 30 min duke llogaritur Kohen prej aksidentit deri na marrjen e terapis. b)dhimbje fizike te intenzitetit te rende 24 ore(kohe pas kohe deri ne marrjen e terapis adekuate).c) dhimbje fizike te intenzitetit te mesem 14 dite(kohe pas kohe deri ne marrjen lendimit ne aksident. d)dhimbje fizike te intenzitetit te ulet sipas te dhenave te marra direkt nga paditesi ka edhe sote e kesaj dite sidomas pas sforcimeve fizike dhe ndryshimeve klimatike.2.Zvoglim te aktivitetit jetesor nuk ka.3 Shemtim trupor nuk Ica..4.Ndihma e personit tjetër ka qene e nevojshme per 14 ditesh per shkake te traumes 5.Ushqim i perforcuar ka qene i domosdoshem ne kohezgjatje prej 20 diteve ne kuptim te perzgjedhjes se ushqimit te pasur me materjet e nevojshme per shkake te rikuperimit te organizmit pas traumes.6.Rehabilitimi fizioerapeutik cihe klimatik ka qene i nevojshem ne kohezgjatje prej 10 ditesh per vitin e pare pas aksidentit. **Per** paditesen A. T. Ne baze te egzaminimit te dokumentacionit mjekesor ne shkresat e lendes,dokumentacionit shtese te cilat i kame kerkuar per egzaminim si dhe egzaminimit te drejtperdrejt te paditeses konstatoj se ne aksidentin e pesuar me daten01.05.2021 ka marre keto lendime:Ka pesuar keto lendime .ndrydhje e kokes ,qafes dhe gjoksit. Ketto lendoime klasifikohen si te lChta trupore,te c:lat kane shkaktuar dhimbje fizike.a)dhimbje fizike te intenziteti te posaqerisht te larte 30 min duke llogaritur Kohen prej aksidentit deri na marrjen e terapis. b)dhimbje fizike te intenzitetit te rende 24 ore(kohe pas kohe deri ne marrjen e terapis adekuate).c) dhimbje fizike te intenzitetit te mesem 14 dite(kohe pas kohe deri ne marrjen eterapis adekuate duke llogaritur fillimin e konsolidimit te organizmit si pasoj e lendimit ne aksident.d)dhimbje fizike te intenzitetit te ulet sipas te dhenave te marra direkt nga paditesja ka edhe sote e kesQj dite sidomas pas sforcimeve fizike dhe ndryshimeve klimatike.2.Zvoglim te aktivitetit jetesor nuk ka.3.Shemtim trupor nuk ka. 4.Ndihma e personit tjetër ka qene e nevojshme per 14 ditesh per shkake te traumes 5.Ushqim i perforcuar ka qene i domosdoshem ne kohezgjatje prej 20 diteve ne kuptim te perzgjedhjes se ushqimit te pasur me materjet e nevojshme per shkake te konsolidimit te ashtit pas thyerjes qeñe Rehabilitimi fizioterapeutik dhe klimatik ka qen i nevojshem ne kohezgjatje prej 10 ditesh per vitin e pare pas aksidentit . **Per** paditsen K. T. Ne baze te

egzaminimit të dokumentacionit mjekësor në shkresat e lëndës, dokumentacionit shtese të cilat i kanë kërkuar për egzaminim si dhe egzaminimit të drejtperdrejt të paditeses konstatohet se në aksidentin e pesuar me datën 01.05.2021 ka marrë keto lëndime. Ka pesuar keto lëndime ndrydhje e kokës, qafës dhe gjoksit. Te gjithë keto lëndime klasifikohen si lëndime të lehta trupore, të cilat kanë shkaktuar dhimbje fizike. a) dhimbje fizike të intenziteti të posaqerisht të lartë 30 min duke llogaritur Rohen prej aksidentit deri në marrjen e terapis. b) dhimbje fizike të intenzitetit të rëndë 24 orë (kohe pas kohe deri në marrjen e terapis adekuate). c) dhimbje fizike të intenzitetit të mesëm 14 ditë (kohe pas kohe deri në marrjen e terapis adekuate duke llogaritur fillimin e konsolidimit të organizmit si pasojë e lëndimit në aksident. d) dhimbje fizike të intenzitetit të ulët Sinas të dhenave të marra direkt nga paditesja ka edhe sote e kesaj dite sidomas pas sforcimeve fizike dhe ndryshimeve klimatike. 2. Zvoglim të aktivitetit jetësor nuk ka. 3. Shëmtim trupor nuk ka. 4. Ndihma e personit tjetër ka qenë e nevojshme për 14 ditë për shkak të traumës. 5. Ushqim i përforcuar ka qenë i domosdoshëm në kohezgjatje prej 20 ditëve në kuptim të perzgjedhjes së ushqimit të pasur me maieriet e nevojshme për shkak të konsolidimit të ashtit pas thyerjes. 6. Rehabilitimi fizioterapeutik dhe klimatik ka qenë i nevojshëm në kohezgjatje prej 10 ditësh për vitin e parë pas aksidentit.

Per paditesen N. K., Në bazë të egzaminimit të dokumentacionit mjekësor në shkresat e lëndës, dokumentacionit shtese të cilat i kanë kërkuar për egzaminim si dhe egzaminimit të drejtperdrejt të paditeses konstatohet se në aksidentin e pesuar me datën 01.05.2021 ka marrë keto lëndime, Ka pesuar keto lëndime ndrydhje e kokës, qafës dhe gjoksit. Te gjithë keto lëndime klasifikohen si lëndime të lehta trupore, të cilat kanë shkaktuar dhimbje fizike. a) dhimbje fizike të intenziteti të posaqerisht të lartë 30 min duke llogaritur Kohen prej aksidentit deri në marrjen e terapis. b) dhimbje fizike të intenzitetit të rëndë 24 orë (kohe pas kohe deri në marrjen e terapis adekuate). c) dhimbje fizike të intenzitetit të mesëm 14 ditë (kohe pas kohe deri në marrjen e terapis adekuate duke llogaritur fillimin e konsolidimit të organizmit si pasojë e lëndimit në aksident. d) dhimbje fizike të intenzitetit të ulët sipas të dhenave të marra direkt nga paditesja ka edhe sote e kesaj dite sidomas pas sforcimeve fizike dhe ndryshimeve klimatike. 2. Zvoglim të aktivitetit jetësor nuk ka. 3. Shëmtim trupor nuk ka. 4. Ndihma e personit tjetër ka qenë e nevojshme për 14 ditë për shkak të traumës. 5. Ushqim i përforcuar ka qenë i domosdoshëm në kohezgjatje prej 20 ditëve në kuptim të perzgjedhjes së ushqimit të pasur me materjet e nevojshme për shkak të konsolidimit të ashtit pas thyerjes. 6. Rehabilitimi fizioterapeutik dhe klimatik ka qenë i nevojshëm në kohezgjatje prej 10 ditësh për vitin e parë pas aksidentit.

Nga ekspertiza psikiarike E përgatitur nga Prof Asoc Dr. N. F., gjykata ka vërtetuar se Ekspert gjyqësorë i Psikiatrisë, Çënfikuar nga KGJK, nr 713/23, dt. 6 prill 2023, Psikiatër, Nr. licencës KO-OI 102-01-35, Doktor i shkencave në psikologji, Profesor i asociuar i Psikiatrisë në Kolegjin Mjekësorë "Rezonanca", Shërbime ekspertimi që nga viti 2004, Ernërimi si ekspert gjyqësor nga Gjykata e Qarkut në Prizren me vendimin I.Agj.nr.4/2011-4 nga viti 2011, Trajnimin Bazik nga projekti i EU dhe THL-Finlandë: Thërnëlimi i Institutit të Psikiatrisë Forenzike Kosovë, Tetor-Nëntor 2012 Prishtinë, Trajnimi Avancuar nga projekti i EU dhe THL-Finlandë: Thërnëlimi i Institutit të Psikiatrisë Forenzike Kosovë, Mars-Prill 2013 Prishtinë, Mendimin –ekspertizën e ka bazuar në dokumentacionin e lëndës që më ka ofruar GJTH në Prizren, Dega në Dragash: Raportin e emergjencës të Spitalit Regjional në Prizren, nr 7758, të datës 01.05.2021, në emër të K. T., Raportin e emergjencës të Spitalit Regjional në Prizren, nr 7740, të datës 01.05.2021, në emër të Violeta Tahiri, Raportin e emergjencës të Spitalit Regjional në Prizren, nr 7741, të datës 01.05.2021, në emër të Drenusha Tahiri, Raportin e emergjencës të Spitalit Regjional në Prizren, nr 7739, të datës 01.05.2021, në emër të A. T., Raportin e emergjencës të Spitalit Regjional në Prizren, nr 7742, të datës 01.05.2021, në emër të N. K., Ekzaminimin psikiatrik të kryer me dt. 07.07.2024, të paditëseve K. T., V. T., D. T., A. T. dhe N. K. Shqyrtimin e literaturës shkencore, Dijeninë time, trajnimin dhe përvojën time në fushën mjekësore dhe psikiatrike, me qrast ka gjetur se të : Paditëset K. T., V. T., D. T., A. T. dhe N. K. në datën 01.05.2021, kanë pësuar lëndime trupore dhe frikë në një aksident të komunikacionit. Ndërkohë paditëset e kanë hapur edhe procedurën civile lidhur me kompensimin e dëmit. Pikë kontestuese është edhe frika e përjetuar nga ana e paditëseve.

Përmbledhja dhe mendimi : 1.K. T.: Frika primare:Ka përjetuar frikë primare që ka zgjatur 2-3 sekonda në momentin e perceptimit të goditjes nga makina tjetër dhe mundësisë së përjetimit fatal për veten, të manifestuar në formë të një bllokade emocionale. Frika sekondare: Ka përjetuar frikë sekondare të intensitetit të lartë- 24 orë, të manifestuar si shqetësim intensiv nga rasti me frikë që shfaqej sa herë përballëj me gjendjen e saj shëndetësore dhe mundësinë e përjetimeve fatale për vetveten. Kjo ishte manifestuar me prishje të gjumit, mendime negative, shpërthime të vajit dhe dridhje të trupit. Ka përjetuar frikë sekondare të intensitetit të mesëm- një javë, e manifestuar si brengosje e vazhdueshme per gjendjen e saj shëndetësore si dhe dhimbjet e kohëpaskohshme në trup. Poashtu në këtë periudhë ka ndërë ankth, frikë, pagjumësi, plogështi dhe ndjeshmëri të tepruar emocionale.Kurse mund të konstatohet edhe frikë sekondare me intensitetit të ultë që ka vazhduar rreth 10 muaj e manifestuar me frigë dhe pasiguri të kohë pas kohshme, prishje të gjumit, nervozizëm, kujtime traumatike si dhe vështirësi në përfshirje në aktivitete të lidhura me komunikacionin. 2.V. T., Frika primare: Ka përjetuar frikë primare që ka zgjatur 2-3 sekonda në momentin e perceptimit të goditjes nga makina tjetër dhe mundësisë së përjetimit fatal për veten, të manifestuar në formë të një britme çjerrëse. Frika sekondare:Ka përjetuar frikë sekondare të intensitetit të lartë- 24 orë, të manifestuar si shqetësim intensiv nga rasti me frikë që shfaqej sa herë përballëj me gjendjen e saj shëndetësore dhe mundësinë e përjetimeve fatale për vetveten. Kjo ishte manifestuar me pamundësi të fjetjes, mendime negative, plogështi, rrahje të shpejta të zëmres, një ndjesi të ngulfatjes dhe dridhje të trupit.Ka përjetuar frikë sekondare të intensitetit të mesëm- një javë, e manifestuar si brengosje e vazhdueshme per gjendjen e saj shëndetësore si dhe dhimbjet e kohëpaskohshme në trup. Poashtu në këtë periudhë ka ndërë ankth, frikë, pagjumësi, trullim, plogështi ndjeshmëri të tepruar emocionale dhe nervozizëm të shtuar.Kurse mund të konstatohet edhe frikë sekondare me intensitetit të ultë që ka vazhduar rreth 10 muaj e manifestuar me frigë dhe pasiguri të kohë pas kohshme, prishje të gjumit, nervozizëm, kujtime traumatike si dhe vështirësi në përfshirje në aktivitete të lidhura me komunikacionin. 3. D. T.:Frika primare:Ka përjetuar frikë primare që ka zgjatur 2-3 sekonda në momentin e perceptimit të goditjes nga makina tjetër dhe mundësisë së përjetimit fatal për veten, të manifestuar në formë të një bllokade emocionale. Frika sekondare:Ka përjetuar frikë sekondare të intensitetit të lartë- 24 orë, të manifestuar si shqetësim intensiv nga rasti me frikë që shfaqej sa herë përballëj me gjendjen e saj shëndetësore dhe mundësinë e përjetimeve fatale për vetveten. Kjo ishte manifestuar me pamundësi të fjetjes, mendime negative, pasiguri, shpërthime në vaj, rrahje të shpejta të zëmres dhe dridhje të trupit. Ka përjetuar frikë sekondare të intensitetit të mesëm- një javë, e manifestuar si brengosje e vazhdueshme per gjendjen e saj shëndetësore si dhe dhimbjet e kohëpaskohshme në trup. Poashtu në këtë periudhë ka ndërë ankth, frikë, pagjumësi, plogështi, ndjeshmëri të tepruar emocionale dhe nervozizëm të shtuar.Kurse mund të konstatohet edhe frikë sekondare me intensitetit të ultë që ka vazhduar rreth 12 muaj e manifestuar me frigë dhe pasiguri të kohë pas kohshme, prishje të gjumit, nervozizëm, ruminacione, kujtime traumatike si dhe vështirësi në përfshirje në aktivitete të lidhura me komunikacionin. 4.A. T.: Frika primare: Ka përjetuar frikë primare që ka zgjatur 2-3 sekonda në momentin e perceptimit të goditjes nga makina tjetër dhe mundësisë së përjetimit fatal për veten, të manifestuar në formë të një bllokade emocionale. Frika sekondare:Ka përjetuar frikë sekondare të intensitetit të lartë- 24 orë, të manifestuar si shqetësim intensiv nga rasti me frikë që shfaqej sa herë përballëj me gjendjen e saj shëndetësore dhe mundësinë e përjetimeve fatale për vetveten. Kjo ishte manifestuar me pamundësi të fjetjes, mendime negative, pasiguri, shpërthime në lotë, rrahje të shpejta të zëmres dhe dridhje të trupit.Ka përjetuar frikë sekondare të intensitetit të mesëm- një javë, e manifestuar si brengosje e vazhdueshme per gjendjen e saj shëndetësore si dhe dhimbjet e kohëpaskohshme në trup. Poashtu në këtë periudhë ka ndërë ankth, frikë, pagjumësi, trullim, plogështi, ndjeshmëri të tepruar emocionale dhe nervozizëm të shtuar.Kurse mund të konstatohet edhe frikë sekondare me intensitetit të ultë që ka vazhduar rreth 10 muaj e manifestuar me frigë dhe pasiguri të kohë pas kohshme, prishje të gjumit, nervozizëm, kujtime traumatike si dhe vështirësi në përfshirje në aktivitete të lidhura me komunikacionin.5.N. K.:Frika primare Ka përjetuar frikë primare që ka zgjatur 2-3 sekonda në momentin e perceptimit të goditjes nga makina tjetër dhe mundësisë së përjetimit fatal për veten, të manifestuar në formë të një britme çjerrëse. Frika sekondare:Ka përjetuar frikë sekondare të intensitetit të lartë- 24 orë, të manifestuar si shqetësim intensiv nga rasti me frikë që shfaqej sa herë përballëj me gjendjen e saj shëndetësore dhe mundësinë e përjetimeve fatale për vetveten. Kjo ishte anifestuar me pamundësi të fjetjes, mendime negative, shpërthime në vaj, rrahje të shpejta të zëmres dhe dridhje të trupit.Ka përjetuar frikë sekondare të intensitetit të mesëm- dy javë, e manifestuar si brengosje e vazhdueshme per gjendjen e saj shëndetësore si dhe dhimbjet e kohëpaskohshme në trup. Poashtu në

këtë periudhë ka ndjerë ankth, frikë, pagjumësi, trullim, plogështi, ndjeshmëri të tepruar emocionale dhe nervozizëm të shtuar. Kurse mund të konstatohet edhe frikë sekondare me intensitetit të ultë që ka vazhduar rreth 12 muaj e manifestuar me frigë dhe pasiguri të kohë pas kohshme, prishje të gjumit, nervozizëm, kujtime traumatike si dhe vështirësi në përfshirje në aktivitete të lidhura me komunikacionin. Mund të konfirmoj se konstatimet dhe vështrimet e shprehura janë të vërteta dhe të bazuara në dijen time më të mirë.

Gjykata me aprovimin e pjesshëm të kërkesëpadisë së paditësit dhe lartësinë e të njëjtës për dëmin material për ndihmën e personit të tretë dhe ushqimin e përforcuar vendimin mori në mbështetje me praktikën e gjykatave për këto kategori te kompensimeve. Sa i për këtë dëmit jo material pati parasysh faktin se lëndimet e pësura janë lëndime të lehta trupore. Për lartësinë e kërkesë padisë dhe për kategoritë e caktuara për aspektin e dëmit jo material gjykata vendosi duke u mbështetur në dispozitat e nenit 183 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, e lidhur me nenin 323 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, me këtë rast gjykata pati parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës, dhe qëllimin të cilit i shërben kompensimi i gjykuar, gjithmonë duke pasur parasysh, që kompensimi të jetë satisfaksionin, për të dëmtuarin, duke ndikuar kështu në zbutjen e pasojave negative që janë paraqitur si pasojë e dëmit në cenimin e vlerave personale të paditësit.

Gjykata pasi konstatoi rrethanat e rastit duke pasur parasysh lartësinë e kompensimit për këtë kategori të dëmit jo material, Gjykata e mori parasysh natyrën e lëndimeve trupore të cilat i kishin pësuar paditësit në aksidentin e ndodhur, mënyrën e manifestimit, intensitetit dhe kohëzgjatjen e frikës së përjetuar, moshën e paditësit në kohën e aksidentit, por edhe praktikën e gjertanishme gjyqësore, duke u siguruar që kompensimi në shumën e gjykuar për këtë lloji dëmi të jetë satisfaksion për paditësin, duke shmangur qëllimet tjera materiale (lukrative) që mund të bien ndesh me qëllimin e kompensimit në raste të tilla, praktikën e mirë gjyqësore, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit në pjesën e aprovuar, si dhe duke iu referuar paragrafit 2 të nenit 200 të LMD-së përcaktohet se “*me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jo material, si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, e gjithashtu edhe për faktin se me të, të mos u shkojë përshat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror*”. Pra, nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore rezulton se kompensimi duhet të jetë adekuat me kohëzgjatjen e dhimbjeve të përjetuara, ashtu që kompensimi të përfaqësojë një lehtësim në përbalimin e tejkalimit të pasojave të dëmit që në këtë rast paditësit i kanë pësuar në aksidentin e komunikacionit.

Gjykata vlerëson se shpërblimi i dëmit jo material, nuk është shpërblim i plotë, por është satisfaksion, për të dëmtuarin, çka në rastin konkret shumat e gjykuara janë të drejta për të.

Gjykata në tërësi i ka pranuar konstatimet të eksperteve me fjalë të njëjtit janë dhënë nga ana e ekspertëve përkatës, të njëjtat përputhen në mes veti si dhe me provat tjera e posaçërisht me dokumentacionin mjekësor që ju është bashkangjitur shkresave të lëndës.

Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë që ndërlihet me dëmin material dhe për dëmin jo material gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit pasi që vlerësoi se kompensimi përtej shumës së gjykuar nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur dhe me qëllimin që kompensimi të ishte i drejtë.

Baza Ligjore :

Baza juridike e kërkesë padisë, që e paditura të jetë përgjegjëse për të kompensuar paditësit gjejnë mbështetje në dispozitat e nenit 136.1, 140 dhe 159.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Sipas dispozitës së nenit 136 të LMD-së, parashihet se kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë të ja kompensoi, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij, ndërsa me dispozitën e nenit 140, parashihet se fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje apo nga pakujdesia, kurse me dispozitën e nenit 159 parashihet se “në rast aksidenti të shkaktuar nga automjeti në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një poseduesi të automjetit vihen në zbatim rregullat mbi përgjegjësin në bazë të fajësisë”.

Në bazë të lartcekurave Gjykata ka vërtetuar se e paditura është përgjegjëse ndaj paditësve Ligji mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) 04/L-077, rregullon çështjen e kompensimit të dëmit (material dhe jo material). Neni 136 par. 1 ka përcaktuar se kush i shkakton dëm tjetrit ka për detyrë ta kompensoi, për veç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij, ndërsa me nenin 137 i LMD-së thotë: Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material). Kurse me dispozitën e nenit 183 par. 1 e LMD-së përcaktohet se për dhembjet e pësuar fizike, si dhe frikës, gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material.

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Prandaj gjykata duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, duke i vlerësuar të gjitha kriteret dhe masat për caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit material dhe jo material, posaçërisht duke marr parasysh natyrën dhe shkallen e dëmtimeve trupore të shkaktuar për paditësin, moshën e tij, vlerësimin në ekspertizave mjekësore për pjesët trupore të lënduara, kohëzgjatjen dhe intensitetin e dhimbjeve fizike dhe frikës, shëmtimin, etj miratoj pjesërisht kërkesëpadinë.

Në emër të ushqimit të përforcuar gjykata ka caktuar kompensimin bazuar në ditët dhe atë dite që ishte vlerësuar si e domosdoshme sipas ekspertizës duke llogaritur shumë nga 7 euro në ditë , si shpërblim i drejtë dhe që i shërben qëllimit të shpërblimit sepse paditësit sipas mendimit të ekspertëve të mjekësisë si pasojë e aksidentit ka pasur nevojë për ushqim të përforcuar i pasur me vitamina dhe minerale. Në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj gjykata ka caktuar kompensimin në harmoni ditët që secili paditës kishte nevojë për këtë lloj ndihme duke llogaritur shumën në muaj prej 100,00 euro , ngase sipas mendimit të ekspertëve të mjekësisë si pasojë e aksidentit kan pasur nevojë për ndihmën dhe kujdesin e huaj për t'i kryer shumicën e aktiviteteve të përditshme jetësore si ne ekspertiz .. Gjykata për kategoritë e dëmit ushqim i përforcuar dhe ndihmë dhe kujdes i huaj, vlerëson se mund të caktohet edhe në mungesë të provave materiale, ngase është standard i ndërtuar tashmë nga praktika gjyqësore, dhe vështirë i argumentuar. Andaj pas analizimit të të gjitha provave ka ardhur në përfundim se shumata e gjykuara të shpërblimit të dëmit për këto kërkesa janë në përputhje me dëmin e pësuar sipas këtyre bazave.

Gjykata vlerëson se shumata e kompensimit të aprovuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi janë adekuate, duke marr parasysh dëmin që i është shkaktuar paditësit dhe se lartësia e shumës së të hollave në emër të kompensimit, do t'i mundësoj paditësit satisfaksion që ai të jetë në gjendje që deri në një masë, t'i kompensojnë të mirat jo materiale nga të cilat janë privuar, respektivisht atë shkallë të satisfaksionit të cilën ai do ta kishte po qesë të njëjtit nuk do t'i kishte humbur, e gjithë kjo duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e lëndimeve të shkaktuara, intensitetin e dhimbjeve dhe të frikës, kohëzgjatjen e tyre dhe kohën e nevojshme të shërimit. Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit material dhe jo material, si dhe në lidhje me shumë kompensimit të këtij dëmi, mes tjerash gjykata ka pasur parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, e gjithashtu kriteret e vëna nga praktika gjyqësore.

Duke qenë se pas administrimit të gjitha provave, gjykata ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë, po ashtu ka vërtetuar se të paditësit i takon edhe kamatëvonesa, gjykata lidhur me lartësinë e kamatës së llogaritur prej 8 % në vit vendosi në kuptim e Cila për dëmin jo material fillon të rrjedh nga data e nxjerrjes së aktgjykimit, ndërsa për dëmin material që lidhen me dëmin jo material nga data e aksidentit datë

15.05.2017 e deri në pagesën definitive, (sipas mendimit juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës Nr. 265/2020 të datës 02.12.2020) në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit e nën kërcenim të ekzekutimit të dhunshëm. E duke u bazuar dhe në nenin 382 paragrafi 2 të LMD – së, sepse pala paditëse për dëmin dhe lartësinë e tij, ka ra në dijeni në momentin kur gjykata ka vendosur dhe nga ai moment kërkesa e paditësit për kompensim dëmi është bërë e kërkueshme dhe konsiderohet se e paditura ka ra në vonesë për përmbushjen e detyrimit. Për çka edhe rrjedha e kamatës është caktuar nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit.

Gjykata lidhur me kompensimin e dëmit material për automjetin e markës “Audi A3” me targat të regjistrimit 04-639-FH ku detyrohet këtu e paditura që të kompensojë këtu paditësit Gëzim Tahiri dëmin e shkaktuar në aksidentin e dt. 01.05.2021 shumën prej 1,010.95 € është zgjidh me pajtim gjyqësor në shyrtrimin e mbajtur me dat 29.08.2024 , andaj dhe provat e administruara dhe shkresat e lexuara lidhur me dëmin në automjet në këtë aktgjykim nuk kanë pas ndikim në vendosje si në dispozitiv të këtij aktvendimi .

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është nxjerrë konform nenit 449 dhe 452.2 të LPK-së dhe në bazë të TA-së së aplikueshme së Odës së Avokatëve. si në vijim: për përpilim të padisë shumën prej 624.00€, Taksa për padi 41.00€, seancat e mbajtura 1 seancë me 2. Paditës x 312 €, = 312.00€, një seancë me katër paditës x 520= 520.00 euro , 5 seanca me 6 paditës x 624.00 €= 3,120.00€. Për ekspertizë të ortopedisë shumën prej 350.00€, për ekspertizë të psikiatrisë shumën prej 350.00 €, për ekspertizë të Komunikacioni dhe të Makinerisë shumën prej 300.00€, gjithsejtë në shumë prej 5,517.00€ (pesëmijë e pesëqindtë e shtatëmbëdhjetë euro) .

Vendimi ku refuzohet kërkesa për shpenzimet procedurale shuma 3,260.00€ përtej shumës së pranuar si më lartë është refuzuar si e pa bazuar dhe atë sipas dispozitave ligjore të LPK-ës e në bazë të TA-së së aplikueshme .

Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 143 par.1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2021:102994, 29.08.2024**

Procesmbajtësi

Senida Nuri

Gjyqtari/ja

Sabaheta Kurteshi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate.